



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

### NJOFTIM

Datë 30 dhjetor 2020

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 43 pika 2, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 5 pika 3 të Rregullores “Mbi transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele” miratuar me Vendimin nr.261, datë 17.11.2020 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë Këshilli i Lartë i Prokurorisë shpall sot thirrjen për fillimin e procedurave për plotësimin e pozicioneve vakante në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, pranë Gjykatave të Shkallës së Parë dhe të Apelit, përmes procedurës së transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele si më poshtë:

1. Pozicion vakant nr.1 Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë shpallur me vendimin nr.330, datë 29.12.2020
2. Pozicion vakant nr.2 Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë shpallur me vendimin nr.331, datë 29.12.2020
3. Pozicion vakant nr.3 Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë shpallur me vendimin nr.332, datë 29.12.2020
4. 1 Pozicion vakant në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër shpallur me vendimin nr.333, datë 29.12.2020
5. 1 Pozicion vakant në Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Vlorë shpallur me vendimin nr.334, datë 29.12.2020
6. Pozicion vakant nr.1 Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Durrës shpallur me vendimin nr.325, datë 29.12.2020
7. Pozicion vakant nr.2 Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Durrës shpallur me vendimin nr.326, datë 29.12.2020
8. Pozicion vakant nr.1 Prokuroria pranë Shkallës së Parë Tiranë shpallur me vendimin nr.319, datë 29.12.2020
9. Pozicion vakant nr.2 Prokuroria pranë Shkallës së Parë Tiranë shpallur me vendimin nr.320, datë 29.12.2020
10. Pozicion vakant nr.3 Prokuroria pranë Shkallës së Parë Tiranë shpallur me vendimin nr.321, datë 29.12.2020
11. Pozicion vakant nr.4 Prokuroria pranë Shkallës së Parë Tiranë shpallur me vendimin nr.322, datë 29.12.2020
12. Pozicion vakant nr.5 Prokuroria pranë Shkallës së Parë Tiranë shpallur me vendimin nr.323, datë 29.12.2020
13. Pozicion vakant nr.6 Prokuroria pranë Shkallës së Parë Tiranë shpallur me vendimin nr.324, datë 29.12.2020

14. Pozicion vakant nr.1 Prokuroria pranë Shkallës së Parë Durrës shpallur me vendimin nr.327, datë 29.12.2020
15. Pozicion vakant nr.2 Prokuroria pranë Shkallës së Parë Durrës shpallur me vendimin nr.328, datë 29.12.2020
16. Pozicion vakant nr.3 Prokuroria pranë Shkallës së Parë Durrës shpallur me vendimin nr.329, datë 29.12.2020
17. Pozicion vakant nr.1 Prokuroria pranë Shkallës së Parë Elbasan shpallur me vendimin nr.341, datë 29.12.2020
18. Pozicion vakant nr.2 Prokuroria pranë Shkallës së Parë Elbasan shpallur me vendimin nr.342, datë 29.12.2020
19. Pozicion vakant nr.3 Prokuroria pranë Shkallës së Parë Elbasan shpallur me vendimin nr.343, datë 29.12.2020
20. 1 Pozicion vakant Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë shpallur me vendimin nr.339, datë 29.12.2020
21. 1 Pozicion vakant Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër shpallur me vendimin nr.340, datë 29.12.2020
22. 1 Pozicion vakant Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës shpallur me vendimin nr.338, datë 29.12.2020
23. 1 Pozicion vakant Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë shpallur me vendimin nr.337, datë 29.12.2020
24. 1 Pozicion vakant Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec shpallur me vendimin nr.336, datë 29.12.2020
25. 1 Pozicion vakant Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë shpallur me vendimin nr.335, datë 29.12.2020

Subjektet të cilët kanë të drejtë të kandidojnë janë:

- a) prokurorët pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm;
- b) prokurorët pranë gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm;
- c) prokurorët e komanduar;
- ç) prokurorët në skemë delegimi.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë i'u bën thirrje që të kandidojnë të gjithë prokurorëve që plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a) të jetë prokuror i Republikës së Shqipërisë;
- b) të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c) të mos ketë qenë anëtar i Këshillit në tri vitet e fundit;
- ç) të ketë të paktën një vit përvojë profesionale në fushën përkatëse të së drejtës gjatë 5 viteve të fundit, përveç rastit të parashikuar nga neni 40, pika 2, germa "b" e ligjit për statusin.

Kandidatët që plotësojnë kushtet e sipërpërmendura i paraqesin kërkesat e deri **më datë 20 janar 2021, ora 16:30.**

Krahas kërkesës për kandidim, kandidatët dorëzojnë pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë

dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kërkesa për shprehjen e interesit ku renditen deri në tre pozicione sipas radhës së preferencës, për të kandiduar për pozicionin/et e lira të shpallur;
- b) Një jetëshkrim i përditësuar;
- c) Vetëdeklarim për mospasjen masë disiplinore në fuqi;
- ç) Vetëdeklarim për mosqenien në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit për Statusin;
- d) Çdo dokument tjetër që e gjykon të arsyeshëm kandidati.

Aplikimet do të dorëzohen në formë elektronike në adresën: [karriera@klp.al](mailto:karriera@klp.al) (në këtë rast të gjitha dokumentat e sipërpërmendura duhet të jenë të skanuara) ose në formë fizike në adresën: Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Rruga “Ana Komnena”, godina e “Polit të Drejtësisë”, Tiranë.